

5864

DL 14.09.2023



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI I ZHVILLIMIT URBAN

Nr. 885/3 prot.

Elbasan, më 12.9.2023

Lënda: Konfirmim akti.

KËSHILLIT BASHKIAK LIBRAZHD

Në zbatim të nenit 16 të ligjit Nr. 107/2016 datë 27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut", u verifikua ligjshmëria e aktit tuaj Nr. 74 datë 31.07.2023 "Për shtesë orari në linjën e transportit rrethqytetas" dhe pasi u njohëm me të dhënat plotësuese të dërguara në institucionin tonë nga Kryetari Bashkisë Librazhd me shkresën e tij me Nr. 5633prot, datë 07.09.2023, konfirmojmë në parim mbështetjen e tij në ligj.

Akti juaj të zbatohet duke respektuar të gjitha procedurat ligjore dhe nënligjore në fuqi që kanë lidhje dhe veprojnë në këtë fushë të veprimtarisë.

PREFEKTI

Majlinda PERRIU





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI I ZHVILLIMIT URBAN

Nr. 885/prot.

Elbasan, më 10.8.2023

Lënda: Mbi ligjshmërinë e aktit

KËSHILLIT BASHKIAK LIBRAZHD

Në zbatim të nenit 16 të ligjit Nr. 107/2016 datë 27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut", përpara se të shprehemi në lidhje me ligjshmërinë e aktit tuaj Nr. 74 datë 31.07.2023 "Për shtesë orari në linjën e transportit rrethqytetas", kërkojmë:

1 - Kopjen e kërkesës së udhëtarëve (me nënshkrimet e tyre përkatëse) drejtuar njësisë tuaj të vetëqeverisjes vendore për shtimin e orareve në linjën e transportit rrethqytetas Dragostunjë-Librazhd-Dragostunjë.

2 - Kopjen e kërkesës së subjektit (me nënshkrimin përkatës) – operues në linjën e transportit të udhëtarëve objekt i aktit tuaj, drejtuar njësisë tuaj të vetëqeverisjes vendore, për shtimin e orareve në linjën e transportit rrethqytetas Dragostunjë-Librazhd-Dragostunjë.

3- Kopjen e shkresës me Nr. 4596prot, datë 04.07.2023.

Deri në dërgimin e këtyre të dhënave, akti juaj mbetet i pa konfirmuar.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LIBRAZHË
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Datë.01.08.2023

Nr. 5099/prot
13

Nr.74 dt.31.07.2023

“PËR SHITESË ORARI NË LINJËN E TRANSPORTIT RRETHQYTETAS “

Në mbështetje të Ligjit Nr. 139/2015 “ Për Vetë Qeverisjen Vendore “ dhe Ligjit nr. 8308 , datë 18.03.1998 “ Për transportet rrugore “ i ndryshuar, “ neni 15 ” , pika “ ç ” me ligjin 10/2016 , “ Udhëzimi nr.5627 , datë 18.12.2016 “ Për përcaktimin e kriterëve për transportin rrugor të udhëtarëve “ , kërkesat e vazhdueshme të subjekteve dhe udhëtarëve , shkresës me nr .4596 prot , date, 04.07.2023 , pasi mori në shqyrtim, Këshilli Bashkiak i mbledhur sot me date 31.07.2023 dhe me propozim të Kryetarit të Bashkisë Librazhd.

VENDOSI:

1. Shtimin e orareve në linjët rrethqytetase , Dragostunjë - Librazhd - Dragostunjë , tabela Nr. 2.2 me nr. kodi. 9.A
Nisja : 07.30,08.45,13.30,16.00
Kthimi : 08.00,12.15,14.15,17.00
(sipas tabelës nr. 2.2 bashkëlidhur).
2. Për zbatimin e këtij urdhëri ngarkohet Sektori i Transportit e Pakingut , Drejtoria e Ardhurave Vendore.
3. Ky urdhër hyn në fuqi mbas 10 ditësh nga dalja e Vendimit të Këshillit Bashkiak.

SEKRETAR I KËSHILLIT
Elson MALLUTA

KRYETARI I KËSHILLIT
Mitat BIGAKU



DREJTORIA E TE ARDHURAVE VENDORE
Sektori i transportit

Oraret e linjës kryesore rrethqytetase Bashkia Librazhd

Data ,14.07.2023

TABELA Nr 2.2

Nr kodit	Linjat Kryesore	Nisja	Kthimi	Nr i orareve
9. A	Dragostunjë - Librazhd - Dragostunjë	07.30,08.45,13.30,16.00	08.00,12.15,14.15, 17.00	4 orare





REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA LIBRAZHD
DREJTORIA E TË ARDHURAVE VENDORE

Librazhd më, 14.07.2023

RELACION
“PËR SHITESË ORARI NË LINJËN E TRANSPORTIT RRETHQYTETAS “

Të nderuar Këshilltare!

Në mbështetje të Ligjit Nr. 139/2015 “ Për Vetë Qeverisjen Vendore” dhe Ligjin, nr. 8308 , datë 18.03.1998 “ Për transportet rrugore “i ndryshuar, “ neni 15” , pika “ ç” me ligjin 10/2016 , “Udhëzimi nr .5627, datë 18.12.2016 “ Për përcaktimin e kriterëve për transportin rrugor të udhëtarëve “, shkresës me nr .4596. Prot, datë 04.07.2023 , kërkesave të udhëtarëve pranë Sektorit të Transportit, Drejtoria e të Ardhurave Vendore, kërkojme që të miratohet shitesë orari në linjën e rregullt rrethqytetase Dragostunjë -Librazhd dhe anasjelltas , pasi linja e specializuar nuk është në ndihme të udhëtarëve dhe kërkesat kanë qënë të vazhdueshme .

Ka patur probleme në transportin e udhëtarëve dhe mos funksionim të mirë të linjes së transportit . Gjithashtu është i domosdoshëm për të ndihmuar e lehtësuar transportin e udhëtarëve në atë zonë të fshatit Dragostunje .

Sa më lart kërkojmë që të miratohen oraret sipas Projekt- Vendimt.

Ju faleminderit !

DREJTORE E TË ARDHURAVE VENDORE
Lindita SHULI